



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:148049
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05625537

Ac.nr.7562/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj, kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Hidajete Gashi Alaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve M. C., A. H., H. H., R. D., R. L., të cilët i përfaqëson sipas autorizimit B. P., avokat nga Komuna e Vushtrrisë, Rruga “Dëshmoret e Kombit” p.n., kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme, në Prishtinë, Rruga “L. H.” p.n., të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës, me përfaqësuesin me avokatin shtetëror N. A., për kompensimin e pagës së trembëdhjetë, pagave jubilarë dhe shujtave ditore, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.5832/21, të datës 17.10.2022, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 23.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pabazuar ankesa e të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.5832/21, të datës 17.10.2022, VËRTETOHET.

II. Pika III e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.5832/21, të datës 17.10.2022, mbetet e pashqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.5832/21, të datës 17.10.2022, ka vendosur si në vijim: I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve M. C. (PK4759), A. H. (PK0672), H. H. (SC1285), R. D. (PK2659), R. L. (PK8842), DETYROHET e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme në Prishtinë, paditësve t’ua paguaj shumat si në vijim: - Paditësit të parë M. C. (PK4759), në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet

2018, 2019, 2020 dhe 2021, t'ia paguaj për çdo vit shumën nga 580.24 €, e në total, shumën prej 2,320.96 €.- Paditësit të dytë A. H. (PK0672), në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, t'ia paguaj për çdo vit shumën nga 531.90 €, e në total, shumën prej 2,127.60 €, dhe në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite, përvojë pune në vlerë të 25%, të një page mesatare të vitit 2020, shumën prej 142.00 €, apo shumën e përgjithshme prej 2,269.60 €.- Paditësit të tretë H. H. (SC1...), në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, t'ia paguaj për çdo vit shumën nga 359.21 €, e në total, shumën prej 1,436.84 €.- Paditësit të katërt R. D. (PK2659), në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, t'ia paguaj për çdo vit shumën nga 664.31 €, e në total, shumën prej 2,657.24 €, dhe në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite, përvojë pune në vlerë të 25 %, të një page mesatare të vitit 2020, shumën prej 142.00 €, apo shumën e përgjithshme prej 2,799.24 €. - Paditësit të pestë R. L. (PK8842), në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, t'ia paguaj për çdo vit shumën nga 557.73 €, e në total, shumën prej 2,230.92 €. II. DETYROHET e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës, Drejtoria Përgjithshme, në Prishtinë, Rruga "Luan Haradinaj" p.n., të ju paguaj paditësve M. C. (PK4.....), A. H. (PK0....), H. H. (SC1.....), R. D. (PK2.....), R. L. (PK8....), shumat e gjykuara si në pikën -I- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me kamatë ligjore në lartësi prej 8 % në vit, e cila fillon të llogaritet nga data 08.07.2021, dita kur është paraqitur padia në këtë gjykatë, e deri në pagesën definitive, dhe shpenzimet e kësaj procedure kontestimore, në shumën prej 724.00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes - pranimi të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit. III. REFUZOHET pjesa e kërkesëpadisë së paditësit të parë, të tretë dhe të pestë, në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë të punës, për secilin nga 142.00 euro, ndërsa në tërësi refuzohen kërkesat e paditësve, me te cilat kanë kërkuar për ta detyruar të paditurën, që paditësve të ju paguaj në emër të shujtave ditore nga 3 € (tri), për çdo ditë të prezencës së paditësve në punë, për periudhën kohore 14.11.2018 e deri më datë 23.02.2022 apo për 740 ditë, të punës për secilin paditës, dhe atë për secilin veç e veç, nga 2,220.00 €, si e pabazuar.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura përmes të autorizuarit së saj, brenda afatit ligjor, ka parashtruar ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apeli ta aprovoj ankesën e paraqitur si të bazuar ndërsa aktgjykimin e atakuar ta ndryshojë ashtu që ta refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve.

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre, kanë paraqitur përgjigje në ankesë përmes së cilës i kanë kundërshtuar pretendimet ankimore të të paditurës me propozim që Gjykata e Apelit ta refuzojë si të pabazuar ankesën e të paditurës ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta vërtetojë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, me datë 08.07.2021, në gjykatën e shkallës së parë, kanë paraqitur padi kundër të paditurës, të cilën e kanë precizuar përmes parashtrësës së datës 04.04.2022, për kompensimin e shpërblimit për pagë të fund vitit, paga jubilarë dhe shujta ditore me pretendimet se të njëjtët janë në marrëdhënie pune me të paditurën dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ mbi Marrëdhënien e Punës në Polici Nr.02/2018, të datës 14.11.2018 të njëjtëve u takojnë këto kompensime (me detaje të tjera si në padi). Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve, në bazë të nenit 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) pasi që ka vlerësuar provat e lëndës pa shqyrtim kryesor të çështjes ka nxjerrë ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.5832/21, të datës 17.10.2022, me të cilin ka vendosur më decidivisht si në dispozitiv të tij.

Në arsyetim të aktgjykimin të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ndër tjera ka arsyetuar se “ në mes të palëve ndërgjyqësve nuk është kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, megjithatë gjykata këtë e vërtetoi edhe nga vërtetimet e punësimit të bashkangjitura shkresave të lëndës për secilin paditës, të cilat janë të datave 08, 12, 13 dhe 22 prill të vitit 2021. Me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e kompensimit për shpërblimin e pagës së fund viteve 2018, 2019, 2020 dhe 2021 dhe shpërblimet jubilar për çdo 10 vite përvojë pune, gjykata mori për bazë vërtetimet e punësimit, të vlerësuara si më lart, për secilin paditës veç e veç, e nga të cilat rezultojnë pagat të cilat i realizojnë paditësit, andaj të njëjtëve për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, iu takojnë secilit veç e veç shumat ashtu siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjykata, aprovoi kërkesën e paditësit të dytë dhe të katërt për sa i përket shpërblimit jubilar në shumën prej 142.00 euro, sa ishte edhe kërkesa e këtyre paditësve, duke mos e lejuar tejkalimin e kërkesë padisë sepse mesatarja e 25%, të një page bazë për vitin 2020, tek të e paditura ishte 174.07 euro, që rezulton të jetë shumë më e lartë se sa është kërkuar nga paditësi i dytë dhe i katërt, mirëpo gjykata në bazë të nenit 2 paragrafi 1 të LPK-së, është e kufizuar të veprojnë brenda kufijve kërkesave të ndërgjyqësve. Sa i përket pjesës refuzuese, gjykata e shkallës së parë theksoj se e refuzoj pjesën e kërkesës së paditësit të parë, të tretë dhe të pestë, që ka të bëjë me shpërblim të 25%, të një page bazë, për 10 vite përvojë pune, sepse për paditësin e parë viti i parë jubilar është arritur në vitin 2012, që në atë kohë dispozitat e udhëzimit administrativ të lart cituara nuk ishin në fuqi, ndërsa vitin tjetër jubilar e arrin në vitin 2022, për paditësin e tretë viti i parë jubilar është arritur në vitin 2016, që në atë kohë dispozitat e udhëzimit administrativ të lart cituara nuk ishin në fuqi, ndërsa vitin tjetër jubilar e arrin në vitin 2026, për paditësin e pestë viti i parë jubilar është arritur në vitin 2015, që në atë kohë dispozitat e udhëzimit administrativ të lart cituara nuk ishin në fuqi, ndërsa vitin tjetër jubilar e arrin në vitin 2025, që për secilin nga këta paditës këto kërkesa ende nuk janë bërë të arritshme.” Lidhur me bazën ligjore është bazuar në nenin 29, paragrafi 1 dhe 2 dhe 30, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës lidhur me nenin 245 të Ligjit mbi Marrëdhënien e Detyrimeve. Për kamatën ka vendosur në bazë të nenit 382, paragrafi 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe për shpenzimet në bazë të nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore ngase sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike kur ka vendosur që paditësve t'iu njeh kompensimin për pagën e trembëdhjetë ngase nuk është kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe të njëjtit kanë performancë të kënaqshme në punë tek e paditura, përkatësisht paditësit M. C., A. H., H. H., R. D., R. L. sipas formularëve për vlerësim të performancës rezulton se kanë pasur performancë shumë të mirë për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale për arsyeje se baza juridike e kërkesëpadisë së paditësve për kompensimin e pagës së trembëdhjetë është e rregulluar me dispozita të Ligjit për Policinë e Kosovës nr.04/L-076 nenet 44 dhe 45, Udhëzimit Administrativ nr.4/2017 dhe Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës konkretisht të nenit 29 i cili përcakton të drejtën për pagën e 13 kur kemi të bëjmë me vlerësim të kënaqshëm. Duke u bazuar në këto dispozita materiale të cilat përcaktojnë këto të drejta dhe detyrime për palët ndërgjyqëse dhe gjendjen faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar faktin se paditësi është aktualisht në marrëdhënie pune tek e paditura, për çka edhe drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, duke e aprovuar kërkesë padinë e paditësve dhe detyruar të paditurën që të njëjtëve t'ua shpërblejë (kompensojë) pagat e trembëdhjeta, për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021. Si rrjedhojë, gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësve, duke e detyruar të paditurën që paditësve t'iu paguaj shumat si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar në emër të kompensimit të pagave të 13, me të drejtë është bazuar Udhëzimin Administrativ nr.02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës konkretisht të nenit 29. Paragrafi 2, i cili përcakton të drejtën për pagën e 13 kur kemi të bëjmë me vlerësim të kënaqshëm. Këtë çështje e ka sqaruar edhe Gjykata Supreme e Kosovës përmes Mendimit Juridik GJ.A.nr.213/2023, datë 09.10.2023, në pikën II të tij.

Pretendimi për mungesë buxheti apo mos harmonizimi i Udhëzimit Administrativ me Ligjin për buxhetin është aspekt i brendshëm i të paditurës me organet e veta, pastaj përderisa Udhëzimi ka qenë në fuqi, e paditura nuk mund t'i shmanget detyrimit për përmbushje. Fakti se nuk është bërë përmbushja në procedurë të brendshme administrative nuk nënkupton mungesë të bazës juridike për t'u detyruar nga gjykata për përmbushje.

Gjykata e Apelit të Kosovës, vendosi si në pikën II të këtij aktgjykimi pasi që për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë së paditësve si në pikën III të aktgjykimit të ankimuar me ankesë nuk kishte pretendime ankimore nga e paditura.

Vendimi mbi kamatën e përcaktuar është në përputhje me dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452 të LPK-së dhe me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së dhe tarifës së OAK-së

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.7562/2022, më datë 23.04.2024.

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Besnik Bislimaj